



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 168 prot

Tiranë, më 25/3 2026

VENDIM

Nr. 4 datë 25/3 2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 17/3/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 17.3.2026 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për miratimin e rregullores së shfrytëzimit të hapësirës publike”, bashkëpropozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

Neni 4, pika 24. Çdo pagesë tjetër në buxhetin e bashkisë ose të qarkut, klasifikohet si tarifë kur:

- a) përkon me përcaktimet e pikës 3 të nenit 16 të ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”;

b) nuk është taksë bashkiake, si dhe gjobë e lidhur me to, në përputhje me këtë ligj;
c) paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit dhe këshilli bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar. Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.

Neni 5, gërma (c). Të identifikohet zona ku do të realizohet mbjellja e pemëve, pasi jo çdo hapësirë publike e cila potencialisht mund të shfrytëzohet për aktivitet privat, ka të parashikuar edhe zonë rekreative të gjelbëruar. Pra, detyrimi i mbjelljes së pemëve të jetë i detyrueshëm kur shfrytëzimi i hapësirës publike, dëmton rekreacionin e saj sipas planit të miratuar.

Neni 5, pika 5, gërma (a). Të riformulohet si vijon: “paralajmërim si masë administrative kryesore, e marrë nga strukturat përkatëse inspektuese, në zbatim të ligjit 99/2024 “Për inspektimin” dhe ligjit të posaçëm”

Neni 5, pika 5, gërma (b). Të riformulohet: ”vlerës së përcaktuar në ligjin e posaçëm”;

Neni 5, pika 5, gërma (d). Të riformulohet: “sekuestrimin e përkohshëm të pajisjeve të vendosura në hapësirën publike, në rast refuzimi të rikthimit në gjendjen fillestare të hapësirës publike nga subjekti i inspektimit, pas kalimit të afatit të paralajmërimit apo revokimit të lejes së shfrytëzimit”.

Neni 5, pika 6. Formulimi vjen në kundërshtim me disa nga ligjet sektoriale, siç është Ligji 9780/2007, i ndryshuar, dhe ligji 107/2014, i ndryshuar, në të cilët parashikohet se në rastet e instalimit të strukturave të përkohëshme në territor/hapësirën publike, masa administrative jepet nga organi inspektues, siç janë struktura inspektuese qendrore dhe ato në varësi të NJVV-ve. Ndaj, dispozita duhet formuluar në përputhje me ligjet, të cilat për nga hierarkia prevalojnë ndaj aktit nënligjor;

Neni 5, mbas pikës 6. Të shikohet mundësia për të shtuar një nen ku të përcaktohen afatet e lejeve, nga 30 ditë në dy vite sepse janë të shpërndara në material;

Neni 6, pika 2. Pas presjes të shtohet “në fushën e ndërtimit”;

Neni 6, pika 3, është i paqartë formulimi “në rast mosmarrëveshje vendimmarrja përcaktohet nga gjykata”, në çdo rast kur ka mosmarrëveshje administrative mes organit publik vendimmarrës dhe subjektit që i kundrejtohet vendimmarrja, organi që zgjidh mosmarrëveshjen është gjykata, por nga ana tjetër organi publik e ka marrë vendimin duke përcaktuar dispozitën përkatëse ligjore në bazë të së cilës është marrë vendimi për ndëshkimin e subjektit, ndaj fjalia është e pakuptueshme në raport me dispozitën ligjore të zbatueshme;

Neni 6, pika 4, të qartësohet se si do të përcaktohet nëse kjo rregullore parashikon masa më të favorshme për intersin publik;

Neni 7, pika 1, të sqarohet se sa kohë do të duhet për ta realizuar teknikisht që kjo rregullore të hyjë në fuqi duhet që paraprakisht bashkitë të kenë aksesin e duhur në portalin e-albania dhe që qytetarët të kenë aksesin për të dorëzuar aplikimet e tyre;

Neni 7, pika 6, riformulimi duhet të jetë në përputhje me ligjin për inspektimin dhe ligjet e posaçme, strukturat inspektuese qendrore dhe/ose strukturat vendore inspektuese të ngritura pranë bashkive”; Lidhur me togëfjalëshin “kryen kontrole periodike dhe të papritura,” ky formulim vjen në kundërshtim me parimin e programimit të inspektimit parashikuar në ligjin nr. 99/2024, neni 7 i tij, si dhe dispozitat e Kreut IX/nenet 32, 33 të tij;

Neni 7, pika 7, të definohet qartë impakti ligjor i së drejtes së qytetarëve apo palevë të treta për të paraqitur ankesa/sygjerime, pra deri në çfazë mund të paraqiten këto të fundit, pasi

nëse ankesat mund të paraqiten në çdo kohë, kjo do cenonte parimin e sigurisë juridike pasi subjektet që i nënshtrohen rregullave të këtij akti dhe pajisen në mënyrë të rregullt me lejen e shfrytëzimit, nuk mund të jenë subjekt rishikimi në çdo rast që ata bëhen subjekt ankimi nga qytetarët. Pra, duhet të ketë një fazë paraprake dëgjimi ose transparence për komunitetin përpara dhënies së lejes së shfrytëzimit, në mënyrë që të shmangen pasojat juridiko-civile;

Kreu II , neni 7, pika 1, duhet rishtuar dhe opsioni që deri në krijimin e sistemit të mund të kemi depozitim në formë shkresore pranë sporteleve të bashkive;

Kreu II , neni 7, pika 4, krijimi i regjistrit bëhet me VKM dhe do të marre kohë në hartim, dhe më tej implementim pasi kërkon system të ri. Njesitë vendore nuk janë pjesë e portalit e-albaina, asnjë system i tyre nuk është dhe nuk ka ndërveprim;

Neni 8. pika 4. Akti i revokimit/pezullimit të Lejes nga Kryetari i Bashkisë, si organi më i lartë ekzekutiv në pushtetin vendor, ankimohet në gjykatë ndaj, të specifikohet që e drejta e ankimit të subjektit ushtrohet në gjykatën kompetente sipas afateve të KPRCA, pra, kjo rregullore si akt nënligjor në zbatim të ligjit, duhet të vijë në përputhje me ligjin sektorial duke mos cënuar kompetencat inspektuese të sanksionuara në ligj;

Neni 10, pika 1. Dispozita duhet riformuluar në frymën e ligjeve të sipërcituara. “Struktura qendrore për inspektimin dhe/ose struktura inspektuese prane NJVV, janë përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të rregullores në hapësirat publike dhe evidentimin e rasteve të shfrytëzimit pa leje ose në kundërshtim me lejen e dhënë sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, ligjin për planifikimin dhe atë për inspektimin e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”;

Neni 10, pika 2, riformulimi duhet bërë sipas përcaktimeve ligjore; “Dokumenton shkeljet e konstatuara nëpërmjet akteve administrative që mbahet procesverbal inspektimi/vendim përfundimtar inspektimi, sipas parashikimeve në ligjin për inspektimin dhe ligjin e posaçëm Neni 10. pika 6. Kudo në këtë rregullore në vend të “Inspektorati” apo “Organi i kontrollit” apo “Bashkia” apo “IKMT” dhe “IVMT”, të zëvendësohet me togëfjalëshin “Struktura qendrore për inspektimin dhe/ose struktura inspektuese pranë NJVV”, sipas përkufizimit të sanksionuar në Ligjin 99/2024 “Për Inspektimin në RSH”;

Neni 11, pika 2, propozohet që monitorimi i zbatimit të kushteve të kontratave të shfrytëzimit të jetë përgjegjësi e Inspektoratit Vendor sipas nenit 10, pika 1;

Neni 11, pika 2 dhe 3, parashikohen përgjegjësitë e bashkive për shërbime ndaj hapësirave publike dhe jo atyre që shfrytëzohen nga subjekte private. Rregullorja është e qartë që për mirëmbajtjen e hapësirës që merr është përgjegjës subjekti privat;

Neni 11, pika 3. Hapësirat e qytetit jo të atyre hapësirave që do përdoren nga privatë me marrjen e lejes...;

Neni 11, pika 5, gërma (b), ku kemi monitorim të lejeve nga një strukturë tjetër e bashkisë, drejtoria për çështjet juridike, duhet të hiqet “monitoron zbatimin e lejeve dhe kontratave”;

Neni 12, pika 8. Të riformulohet: “Struktura qendrore për inspektimin dhe/ose struktura inspektuese prane NJVV”;

Neni 13, pika 2, Bashkërendimi i procesit inspektues është detyrim ligjor për strukturën inspektuese qendrore vetëm me sekretariatit e KKTU për lejet e dhëna nga ky i fundit, por jo edhe strukturën inspektuese vendore. Ky përcaktim ligjor është i sanksionuar në Ligjin 9780/2007, i ndryshuar me Ligjin 62/2025, neni 9/pika (e) sipas të cilës “Për lejet e ndërtimit në kompetencë të KKTU, bashkërendon procesin e kontrollit me Sekretariatit Teknik të KKTU-së”;

Neni 13, pika 3, të formulohet; “Struktura qendrore për inspektimin dhe/ose struktura inspektuese pranë NJVV, janë përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të rregullores në hapësirat publike dhe evidentimin e rasteve të shfrytëzimit pa leje ose në kundërshtim me lejen e dhënë sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, ligjin për planifikimin dhe atë për

inspektimin e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” se vjen në kundërshtim me Ligjin kuadër 99/2024 për inspektimin;

Neni 18, pika 2, të qartësohet nëse do të llogariten këto pengesa; pemë, bordura etj si pjesë e 200 cm, apo do të përjashtohen;

Neni 19, pika 2, të shtohet dhe opsioni i depozitimit fizik;

Neni 19, pika 2, gërma (f), duhet vertetimi që nuk ka detyrime tatimore të papaguara ndaj administratës;

Neni 19, pika 4, të rishihet kriteri një karrige një pemë dhe të rritet numri i karrigeve për një pemë në 3. Pra, duhet një pemë e mbjellë në 3 karrige dhe nëse subjekti nuk do të mbjellë pemë, por do të kontribuojë financiarisht, duhet caktuar një vlerë minimale nga vetë bashkitë;

Neni 20, pika 2, të qartësohet si lidhet cmimi i shërbimeve të ofruara nga subjekti (bar, restorant) me tarifën për hapësirën publike. Bashkitë mund të bëjnë vetë studime të tregut për të llogaritur më tej tarifat përkatëse;

Neni 20, pika 4, të qartësohet nëse aktiviteti zgjat pa afat dhe nëse duhet parashikuar një afat maksimal apo mund të lihet në vendimmarrjen e bashkisë;

Neni 25, pika 1. Fjalja “duke reflektuar nivelin e çmimeve reale të faturuara nga aktivitetet e ushtruara” është e paqartë, pasi tarifat vendore rishikohen nga Këshilli Bashkiak në varësi të disa faktorëve, si çmimet e tregut, pesha ekonomiko-financiare e zonës në raport edhe me politikat sociale të bashkisë, ndaj ky definim i tarifës si një vlerë që përcaktohet nga çmimet e faturuara të aktiviteteve që ushtrohen nuk reflekton mekanizmat e përcaktimit të tarifave, ndaj sygjerohet të riformulohet “duke reflektuar çmimet e tregut, si dhe indeksimin periodik të tyre;

Në nenin 25, pika 1, mbjellja e pemës dhe pagesa e lejes është kusht për marrjen e lejes, si dhe të qartësohet mënyra se si do të monitorohet ky proces referuar nenit 5, pika 3, gërma (e), si dhe të qartësohet mënyra si do të llogaritet çmimi, gjithashtu, të mbahet në konsideratë që hapësira publike paguhet mbi baze mujore;

Neni 25, pika 2. Njësitë vendore nuk kanë akses në kasat fiskale/ deklaratimet e subjekteve. Sipas legjit tatimor, mbyllja e deklaratimeve të një viti fiskal bëhet në çdo 31 mars të vitit pasardhës. Një llogaritje e tillë pa metodologji dhe të dhëna është e vështirë të realizohet dhe NJVV të vendosin me këshill bashkiak tarifën duke hequr këtë metodologji;

Neni 26, pika 1. Procesverbali nuk është akti final i dokumentimit të kundravajtjes, vendimi përfundimtar i inspektimit ndaj, të hiqet fjala “procesverbal”;

Neni 26, pika 1, gërma (b). Të saktësohet mënyra se si do të llogaritet masa e gjobës;

Neni 26, pika 1, gërma (c). Në ligjin e procedurave tatimore citohet se: Nëse ke detyrime pa paguar përveç masave shtrënguese, bllokim llogarish bankare, konfiskim pasurie etj, nuk ka masa të tjera;

Neni 26, pika 1, shkronja (b). Neni 37, pika 1, shkronja (b). Në frymën e Ligjit 107/2014 i ndryshuar, për strukturat lëhtësisht të çmontueshme të instaluar në territor në mungesë të lejes/autorizimit përkatës, masa e gjobës së aplikuar është 50.000 lekë deri në 150.000 lekë, duke vlerësuar se instalimi i përkohshëm i pajisjeve/strukturave të lëvizshme në kuadër të përdorimit të hapësirës publike, i përket së njëjtës kategori shkeljeje e rregulluar me ligj, masa e gjobës së aplikuar duhet të jetë në frymën e ligjit;

Neni 26, pika 1, shkronja (c). Të specifikohet nocioni i pezullimit të aktivitetit, nëse kemi të bëjmë me pezullimin e aktivitetit vetëm për atë që ushtrohet në hapësirën publike, apo aktiviteti tregtar i biznesit që ushtrohet dhe nëse është për këtë të fundit, të vlerësohet nëse kjo krijon përplasje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe legjislacionin tatimor;

Neni 26, pika 1, shkronja (e). Pas fjalës “i ankimeshem” të shtohet “në gjykatën kompetente...”;

Neni 26, pika 1, shkronja (f). Kjo tipologji shkeljeje, nuk është subjekt i lejes së shfrytëzimit

të hapësirës publike, e cila rregullohet dhe është objekt i kësaj rregullore, dhe kategorizohet në kundravajtjet në kompetencë të policisë së shtetit që shqyrtohen sipas ligjit sektorial;

Neni 31, pika 1, të hiqet togëfjalëshi ”të gjitha kategoritë e lejeve në rregullore”

Neni 31, pika 1, gërma (d), të shtohet pagesa e detyrimeve vendore;

Neni 31, pika 2, gërma (a), të thjeshtësohet procedura e aplikimit dhe për vetë natyrën e aktivitetit pasi angazhimi i një eksperti të licensuar për një projekt të detajuar është kosto për biznesin;

Neni 32, pika 5, të qartësohet nëse duhet që subjekti të dorëzojë përsëri genplan dhe skica gjatë procesit të rinovimit;

Neni 36, pika 1, të rishikohet metodologjia;

Neni 37, pika 1, shkronja (a). Paralajmërimi përbën dënim kryesor në kuptim të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit 9780/2007 dhe Ligjit 99/2024, ky i fundit dokumentohet me vendimin përfundimtar të inspektimit. Procesverbali nuk është akti final i dokumentimit të kundravajtjes, vendimi përfundimtar i inspektimit ndaj, të hiqet fjala procesverbal;

Neni 37, pika 1, gërma (a) dhe (b). Për masat ndëshkuese, vecanërisht gjrobat, duhet të përcaktohen dhe miratohen nga Bashkia. Nesë tarifat për shfrytëzim do të caktohen dhe miratohen nga bashkia, dhe gjrobat duhet të përcaktohen po nga ajo. Kjo do të lejojë dhe një përshtatshmëri të gjobës me natyrën dhe zhvillimin ekonomik të zonës përkatëse dhe vetë bashkisë. Gjopa nuk mund të jetë e njëjtë në të gjitha bashkitë e vendit si dhe duhet të ketë një diferencim të gjobës për aktivitete të ndryshme e cila nuk mund të jetë njësoj si për restorantet dhe për shitësit e fruta perimeve;

Neni 37, pika 1, gërma (c), Propozohet që aktiviteti pezullohet vetëm në hapësirën publike, jo në të gjithë subjektin;

Neni 44, pika 1, shkronja (a). Kjo tipologji shkelje është në kompetencën dhe subjekt kontrolli nga AKU, sipas ligjit sektorial. Më sipër në këtë projektakt, keni identifikuar si organ përgjegjës kontrolli strukturat vendore inspektuese IVMT, fusha e përgjegjësisë e të cilëve është e mirëpërcaktuar në Ligjin 9780/2007 dhe lidhet vetëm me procesin e inspektimit dhe kontrollit të ndërtimeve të kundërligjshme referuar te neni 5;

Neni 44, pika 1, gërma (d), të qartësohet mënyra dhe marrjes së miratimit nga shitësit ambulantë;

Neni 48, pika 1, gërma (b), sugjerohet që niveli i gjobës duhet të jetë në një raport të drejtë dhe me aktivitetin dhe përfitimet e tij dhe të jetë më e ulët se në rastet e mësipërme;

Neni 53, pika 1, gërma (g), Ky kriter është vetëm për këtë kategori aktiviteti dhe është i panevojshëm vecanërisht ndjekja penale;

Neni 70, pika 2, shkronja (c). Vendosija e strukturave të çmomtueshme/apo me materiale të lehtësuara, në zonat e mbrojtura, pjesë zonës kufizuese të monumeteve të kultures etj, parashikohen në Ligjin 107/2014 të kategoria e shkeljeve që aplikohet masa e gjobës bashkë me gjobën extra për tipologjinë e zonës si kategori me status të veçantë, ku ligji parashikon 10 % të preventivit, ndaj formulimi duhet të vijë në frymën e Ligjit;

Neni 70, pika 2, gërma (ii), të shihet mundësia e gjobave fikse, jo me interval se në administrim krijon probleme;

Neni 75, pika 1, gërma (e), ose vertetim që ka paguar detyrimet tatimore;

Neni 81, pika 1, gërma (a), (b), (c), si më lart,të diferencohet gjopa për shkelje të lehtë, të mesme dhe të rëndë;

Neni 81, pika 4, sugjerohet që garancia pasurore të mos aplikohet në rastet e panairove të cilat në shumicën e rasteve synojnë promovimin e turizmit, kulturës, kulinarisë etj të cilat janë në shërbim dhe të bashkisë;

Neni 128, të shtohet pika 4 për pasjen e një dispozite tranzitore për afatin e hyrjes në fuqi për dy arsye:

- a) Lejet që janë dhënë aktualisht nga bashkitë nuk mund të ndryshohen pasi bashkitë do të përballeshin me ankime administrative nga bizneset,
- b) Rregullorja i referohet aplikimit të e-albania, hartës interaktive të pasurive publike, platformës online me të dhëna për llojin e aktivitetit dhe tarifat, Regjistrin Unik të lejeve. Ajo mund të hyjë në fuqi vetëm pas vënies në funksion të këtyre mjeteve, ose të parashikohen mundësi alternative si psh aplikimi në sportelet e bashkisë deri në momentin e duhur.

Z. Ervin Demo
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor



Z. Aldrin Dalipi
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë

